

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com

GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS

përmes

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS

DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

lidhur me lëndën **A. nr. 3090/19**

Paditës-propozuesi:

Sami Kurteshi

rr. Xhavit Ahmeti, nr. 9/A, 10000 Prishtinë

përfaqësuar me autorizim nga juristi Getoar Mjeku

ndaj të paditur-kundërpropozueses:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) e Republikës së Kosovës

rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000 Prishtinë

paraqet:

PËRGJIGJE NË ANKESË

sipas ligjit:

Ligji për procedurën kontestimore, 03/L-006, ndryshuar, neni 187.1

ndaj parashtrës:

Ankesa e 23 janarit 2020 e së paditur-kundërpropozueses kundër Aktvendimit të 27 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore të Prishtinës

me propozim Gjykatës:

që ta refuzojë ankesën si të pathemeltë dhe të vërtetojë aktvendimin e goditur sepse gjykata ka zbatuar drejt dispozitat ligjore dhe ka konstatuar saktë dhe plotësisht gjendjen faktike

Prishtinë, 30 janar 2020

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
A. Përmbledhje.....	3
B. Çështja në shqyrtim.....	3
C. Procedura dhe faktet.....	3
D. Arsyetimi juridik.....	4
II. Argumentet.....	5
A. Gjykata Themelore ka zbatuar drejt ligjin, duke miratuar kërkesën mbi provat e paraqitura.....	5
B. Gjykata Themelore ka vlerësuar mirë faktet, duke konstatuar rrezikun e dëmit për paditësin dhe duke vënë re interesin publik.....	5
C. Aktvendimi për shtyrje nuk lëshohen në meritat e lëndës.....	7
III. Propozim.....	8

I. HYRJE

A. Përmbledhje

1. Ligji lejon shtyrjen e ekzekutimit të një vendimi administrativ nëse paditësit i kanoset dëm vështirë i riparueshëm, shtyrja nuk cenon interesin publik, dhe shtyrja nuk u shkakton «dëm të madh» palëve të interesuara.¹
2. Gjykata Themelore ka shtyrë një vendim të së paditurës për t'u dhënë subvencione prodhuesve të paracaktuar të energjisë elektrike. Vendimi rrezikonte shtrenjtimin e rrymës për dhjetëra miliona euro në dëm të të paditurit dhe konsumatorëve të tjerë. Shtyrja nuk cenon interesin publik, sepse mbron konsumatorin dhe tregun e lirë. As nuk u sjell dëm të madh palëve të interesuara, meqë subvencionet parashihen për periudhë 12-vjeçare, kurdo që fillon zbatimi.

B. Çështja në shqyrtim

3. Në këtë rast, a ka zbatuar drejt ligjin Gjykata Themelore dhe a i ka konstatuar faktet saktë dhe plotësisht, duke miratuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit?

C. Procedura dhe faktet

4. Më 27 nëntor 2019, e paditura dhe kundërpropozuesja Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një vendim për të caktuar tarifa që u paguhen prodhuesve të energjisë nga burime të caktuara të ripërtëritshme.²
5. Më 24 dhjetor 2019, paditësi dhe propozuesi Sami Kurteshi ka parashtruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës padi ndaj vendimit të ZRrE-së dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit deri në zgjidhjen përfundimtare të kontestit gjyqësor.

1 Ligj 03/L-202, për konfliktet administrative (**LKA**), neni 22.

2 Vendim V_1204_2019 i 27 nëntorit 2019 i Bordit të ZRrE-së, në dosjen e lëndës.

6. Më 27 dhjetor 2019, brenda afatit të ligjshëm, gjyqtarja e nderuar Ar-jeta Sadiku, e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, ka nxjerrë aktvendim që miraton kërkesën e paditës-pro-pozuesit Kurteshi.
7. Aktvendimi i 27 dhjetorit 2019 u është dorëzuar palëve kah mesi i janarit 2020. Përfaqësuesi i paditës-propozuesit ka marrë kopjen e aktvendimit më 14 janar 2020.
8. Më 23 janar 2020, e paditur-kundërpropozuesja ZRrE ka goditur aktvendimin e 27 dhjetorit 2019, duke i paraqitur ankesë Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës.
9. Ankesa i është dorëzuar përfaqësuesit të paditës-propozuesit më 28 janar 2020.

D. Arsyetimi juridik

10. Kur Ligji për konfliktet administrative nuk ka paraparë rregulla për procedurën, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për proce-durën kontestimore.³ Kurse LPK përcakton se në procedurën ankimore ndaj aktvendimit zhvillohen rregullat e procedurës ankimore ndaj akt-gjykimit.⁴ Ankesa dorëzohet në gjykatën e shkallës së parë, e cila e përcjell atë në gjykatën e shkallës së dytë. Kur pala e pakënaqur para-shtron ankesë, gjykata ia dërgon një kopje palës tjetër e cila «mundet, brenda fatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë».⁵
11. Paditës-propozuesi po paraqet këtë përgjigje në ankesë në gjykatën e duhur dhe brenda afatit ligjor — 7 ditë pasi ka pranuar ankesën. Pran-daj, Gjykata e nderuar duhet ta shqyrtojë përgjigjen.

3 LKA, neni 63.

4 Ligj 03/L-006, për procedurën kontestimore (**LPK**), neni 208.

5 LPK, neni 187.1.

II. ARGUMENTET

A. Gjykata Themelore ka zbatuar drejt ligjin, duke miratuar kërkesën mbi provat e paraqitura

12. Aktvendimi i 27 dhjetorit 2019 mbështetet në nenin 22 të Ligjit për konfliktet administrative. Sipas paragrafit 6 të atij neni, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ. Sipas paragrafit 2 të nenit 22, gjykata miraton kërkesën e paditësit nëse:
- (1) ekzekutimi i shkakton paditësit dëm që vështirë riparohet;
 - (2) shtyrja nuk cenon interesin publik; dhe
 - (3) shtyrja nuk i sjell «dëm të madh» palës së interesuar.
13. Në rastin tonë, Gjykata Themelore ka shtyrë ekzekutimit në bazë të parashtresës së z. Kurteshi, që ngërthen padinë dhe kërkesën për shtyrje. Parashtresa — e mbështetur me argumente dhe prova, që përfshijnë llogaritjen e dëmit — përmbush secilin element të kërkesës për shtyrje: se paditësit i kanoset dëmi vështirë i riparueshëm, se shtyrja nuk cenon interesin publik, dhe se shtyrja nuk dëmton palët e interesuara.⁶
14. Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendim të ligjshëm, dhe Gjykata e Apelit duhet ta vërtetojë atë.

B. Gjykata Themelore ka vlerësuar mirë faktet, duke konstatuar rrezikun e dëmit për paditësin dhe duke vënë re interesin publik

15. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar saktë dhe në plotëni gjendjen faktike, ashtu siç përshkruhet në parashtresën e paditës-propozuesit Kurteshi dhe siç mbështetet me fakte notore dhe prova të dorëzuara në gjykatë.
16. Së pari, parashtresa e 24 dhjetorit 2019 dëshmon se vendimi i ZRrE-së shtrenjton rrymën elektrike, duke ua ngarkuar të paktën 16,46 milionë

⁶ Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, pjesa VI, para. 93–98.

euro paditësit dhe konsumatorëve të tjerë. Ky dëm pasuror (dhe çfarëdo dëmi tjetër përcjellës) do të ishte vështirë i riparueshëm pas zgjidhjes përfundimtare të kontestit.⁷

17. Së dyti, mbrojtja e konsumatorit dhe e tregut të lirë është jo vetëm në përputhje me interesin publik — është detyrim kushtetues dhe ligjor i organeve të Republikës së Kosovës, përfshi të paditurën ZRrE.⁸
18. Së treti, vendimi i ZRrE-së parasheh dhënien e subvencioneve për një periudhë 12-vjeçare. Shtyrja e ekzekutimit nuk e pakëson kohëzgjatjen e subvencioneve. Madje, nëse veç lejohet ekzekutimi pas vendimit përfundimtar të gjykatës, prodhuesit do të përfitojnë nga tarifa të larta fikse, ndërkohë që çmimi i energjisë në treg shkon duke rënë.⁹
19. Prodhuesit nuk kanë bërë kurrfarë investimi si rrjedhojë e vendimit të ZRrE-së, nuk kanë qenë palë në procedurë administrative, s'kanë pasur shkas të drejtpërdrejtë të presin përfitime, andaj dhe s'mund të pësojnë dëm nga pezullimi i vendimit.¹⁰ Në ankesën e saj, ZRrE pretendon rrejtshëm se ka caktuar tarifat nxitëse duke marrë parasysh koston e prodhimit dhe investimet e prodhuesve.¹¹ Nëse veç i ka marrë parasysh, është dashur ta cekë këtë në arsyetimin që i mungon vendimit administrativ.¹² Dhe nëse prodhuesit kanë investuar shkaku i vendimit, ata nuk është dashur të investojnë para se vendimi të merrte formë të prerë. Me fjalë të tjera, ZRrE në ankesë po shton deklarata që nuk janë thënë gjatë shqyrtimit të çështjes në procedurë administrative, nuk janë përfshirë në aktin administrativ të 27 nëntorit 2019, e që s'janë asnjë pikë të vërteta ose relevante.¹³
20. Rrjedhimisht, çfarëdo pengese që mund t'u shkaktohet prodhuesve të energjisë, si palë e interesuar, nuk përbën «dëm të madh» sipas kuptimit të nenit 22 të Ligjit për konfliktet administrative. Andaj Gjykata e Apelit duhet ta vërtetojë aktvendimin e shkallës së parë.

7 Po aty, para. 95.

8 Po aty, para. 96–97; shih dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008, ndryshuar 2016), neni 119; Ligjin 05/L-084, për rregullatorin e energjisë, neni 1.1.

9 Po aty, para. 98.

10 Po aty.

11 Ankesa, f. 3, para. 3–4.

12 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, para. 76–80.

13 Shih LPK, neni 180.1 (rreth fakteve të reja në ankesë).

C. Aktvendimi për shtyrje nuk lëshohen në meritat e lëndës

21. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rastin vetëm për atë sa lejohet për të vendosur mbi shtyrjen e ekzekutimit, sipas nenit 22 LKA. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit administrativ ngjason me masat e sigurimit të vendosura në procedurën kontestimore civile. Në cilindo rast, gjykata përmbahet nga vlerësimi i meritave të rastit. Gjykata nuk çmon nëse padia është e bazuar — kjo është punë për shqyrtimin përfundimtar — por nëse ka prova të besueshme për dëmin e kanosur.
22. Në pamundësi për ta goditur aktvendimin e Themelores brenda shkaqeve të lejuara, e paditura ZRrE tani përpiqet ta shtyjë Gjykatën e Apelit drejt vlerësimit të meritave. Për shembull, radhit ndër shkaqe të ankesës zbatimin e së drejtës materiale për sektorin e energjisë.¹⁴ Tute, thirret në «zhvillimin e ekonomik, interesin publik dhe obligimet ndërkombëtare».¹⁵ Por kjo çështje është thelbi i kontestit, ndërsa padia thotë se vendimi i ZRrE-së shkel legjislacionin e sektorit dhe cenon tregun e lirë, interesin publik dhe detyrimet e Kosovës ndaj BE-së.¹⁶
23. E paditura ZRrE gjithashtu keqparaqet padinë, duke thënë se «vendimi i atakuar nga paditësi, nuk ka të bëjë fare me çështjen që pretendohet, pasi që kemi të bëjmë me përcaktimin e tarifës nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike[sic]».¹⁷ ZRrE pretendon se tarifat janë caktuar duke llogaritur investimet e prodhuesve. Z. Kurteshi ka paditur ZRrE-në mu pse ka vendosur tarifa nxitëse, që ndalohen me normat e zbatueshme, dhe pse tarifat nuk i ka caktuar siç lypset me normat e zbatueshme.¹⁸ Duke e thënë të kundërtën, ZRrE tani mundohet njëherë t'i dobësojë meritat e lëndës dhe pastaj ta nxisë gjykatën për t'i vlerësuar ato merita.
24. Gjykata e Apelit duhet të kufizojë shqyrtimin brenda fushëveprimit të nenit 22 LKA, dhe pa u lëshuar në meritat e rastit, ta vërtetojë aktvendimit e shkallës së parë shtyrje të ekzekutimit.

14 Ankesa, f. 1.

15 Po aty, f. 3, para. fundit.

16 Padia, para. 4–7, 47–92.

17 Ankesa, para. 3.

18 Padia, para. 6.

III. PROPOZIM

25. Mbështetur në argumentet e mësipërme, dhe duke u thirrur në Ligjin për procedurën kontestimore, neni 209, paditës-propozuesi i kërkon Gjykatës së nderuar të nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

- I. **Refuzohet** në tërësi si e pathemeltë ankesa e së paditur-kundër-propozueses Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës.
- II. **Vërtetohet** Aktvendimi i 27 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamentit për Çështje Administrative, në lëndën A. nr. 3090/2019.

Përfaqësuesi i paditës-propozuesit:

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com